

Thirrje për trajnim për të rinj

1. Informacione të detajuara për trajnimin

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë hap thirrje për 30 të rinj të cilët janë të interesuar të zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e këshillimit për karrierë dhe punës së drejtpërdrejtë me të rinjtë që kanë nevojë për udhëzime për karrierë.

Të rinjtë që do të zhvillojnë më tej seanca udhëzuese për karrierën do të trajnohen një herë, në periudhën nga 15 janari deri më 17 janar, ndërsa pjesëmarrja në të tria ditët është e detyrueshme. Agjenda për tre ditët do të jetë gjithëditore, përkatësisht nga ora 9:30 deri në orën 17:00, ndërsa vendndodhja do të përcaktohet më tej. Trajnimi do të mbulojë fushat e mëposhtme:

- Komunikimi me të rinjtë dhe puna e drejtpërdrejtë me nxënësit e shkollave të mesme
- Teste për udhëzim për karrierë
- Teknika për punë individuale dhe punë në grup
- Cikli/fazat e planifikimit të karrierës
- Punë praktike

Kushtet që duhet të plotësojnë personat e interesuar:

- Të jenë të diplomuar ose studentë në vitet e fundit të psikologjisë, punës sociale, pedagogjisë, edukimit special dhe rehabilitimit
- Të jenë të lirë nga 15 deri më 17 janar për të ndjekur plotësisht dhe në mënyrë aktive trajnimin
- Të kenë mundësi të udhëtojnë midis shkurtit dhe qershorit në mënyrë që të realizojnë 3 këshillime për karrierë në grup në shkollat e mesme
- Të kenë përvojë pune me të rinjtë.

Të gjithë të rinjtë e interesuar duhet të plotësojnë [linkun e mëposhtëm](#) dhe të paraqesin të dhëna të sakta personale, jo më vonë se data 12.01.2025, deri në mesnatë. Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të njoftohen më 13.01.2025.

2. Informacione të detajuara mbi angazhimin pas përfundimit të trajnimit

Të rinjtë që përfundojnë me sukses trajnimin do të punësohen për të kryer 3 seanca grupore për udhëzime në karrierë në shkollat e mesme në të gjithë vendin. Personat e trajnuar do të marrin kompensimin e duhur financiar për këtë angazhim.

Secila prej këtyre 3 seancave në grup pritet të ketë midis 25 dhe 30 nxënës të shkollave të mesme, dhe kohëzgjatja e këshillimit do të jetë jo më shumë se 2 orë. Gjatë trajnimit do të

zhvillohet një agjendë e detajuar për këto seanca këshillimi në grup dhe pritet të ndiqet nga të gjithë personat e angazhuar.

Pas përfundimit të 3 konsultimeve në grup, personat e angazhuar pritet të përgatisin një raport të shkurtër narrativ që do t'i dorëzohet Këshillit Rinor Nacional të Maqedonisë.

Çdo person i angazhuar do të nënshkruajë një marrëveshje autoriale për angazhimin e lartpërmendur në mënyrë që të pranojë kompensim adekuat për seancat e përfunduara.

3. Informacione të detajuara rreth projektit

Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë dhe Rrjeti Stella morën miratimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit për të zbatuar programet e këshillimit dhe mentorimit të karrierës në të gjitha shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut. Bëhet fjalë për zbatimin e programeve që do të përfundojnë në periudhën janar - qershor 2025.

Nëpërmjet programit për këshillim për karrierë të KRNМ-së, ofrohen mbështetje për nxënësit që janë në dilemë për zgjedhjet e karrierës, zgjedhjen e fakultetit dhe zgjedhjen për karrierë. Programi synon të frymëzojë dhe inkurajojë pjesëmarrësit të ndjekin dëshirat e tyre profesionale, por në të njëjtën kohë të punojnë drejt realizimit të tyre. Takimi i parë është projektuar të jetë një takim në grup me prani fizike, me maksimum prej 30 pjesëmarrësish. Pas përfundimit të trajnimit në grup për zhvillimin e karrierës, nëse është e nevojshme, secili pjesëmarrës ka mundësinë për 3 takime individuale me një këshilltar karriere.

KRNМ dhe Rrjeti Stella kanë zbatuar këto aktivitete për një kohë të gjatë përmes projektit "Mundësi të barabarta për vajzat dhe gratë e reja në Maqedoninë e Veriut", por jashtë arsimit formal. Ideja kryesore e projektit është të mbështesë dhe inkurajojë vajzat dhe gratë e reja nga 15 deri në 29 vjeç në Maqedoninë e Veriut, që të bëhen më aktive në shoqëri dhe të krijojnë qasje të barabarta në mundësitë në jetën publike të vendit, në sektorin privat dhe rrjedhimisht në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe kombëtar. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Shkup, ndërsa pas disa takimeve koordinuese me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, ndodhi edhe miratimi formal që projekti të zbatohet zyrtarisht dhe sistematikisht në çdo shkollë të mesme, në mënyrë që të ketë një qasje më të koordinuar dhe mbulim më të madh të të rinjve me udhëzime profesionale.